



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË”**



**Tiranë, korrik 2025**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	6
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7
8.	Dokumentimi i auditimit	7
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	<b>Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK</b>	8-11
2.2	<b>Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit</b>	12-25
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>25-31</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

KLSH mbështetur në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, nga data 08.01.2025 deri në 21.02.2025.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### **1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në QKK, është pjesë e Planit Vjetor 2025 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në QKK.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1459/2, me datë 06.01.2025.

### **2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:**

#### ***Paraqitja e gjetjeve kryesore:***

- Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk ka miratuar një strategji institucionale zhvillimi, e cila do të duhej të përfshinte edhe komponentët e teknologjisë së informacionit që mbështesin realizimin e objektivave institucionale, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës. Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk disponon regjistër risku, ku të përfshihen dhe risqet e teknologjisë së informacionit, për periudhën objekt auditimi nuk u konstatua asnjë gjurmë e dokumentuar për risqet e identifikuar. Veprime në kundërshtim me nenin 11, pika 2, nenin 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Kjo sjell mungesë të identifikimit dhe adresimit të problematikave potenciale, si dhe rrit riskun për shkelje në fushën e sigurisë së informacionit.

- Qendra Kombëtare e Kinematografisë përdor sistemet AMS (Sistemi i Menaxhimit të Aplikimeve) dhe SQDNE (Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik) të cilat janë zhvilluar nga AKSHI, për ofrimin e katër shërbimeve online (1. Aplikim për regjistrimin vjetor të Producentëve, 2. Aplikim për regjistrimin vjetor të Distributorëve/Difuzorëve, 3. Aplikim për konfirmim financimesh për projektet e miratuara dhe 4. Aplikim për pajisje me leje qarkullimi filmat që shfaqen në territorin e Republikës së Shqipërisë), nga ku u konstatua se:

- Për sistemet AMS dhe SQDNE përdor vetëm rolin specialist për të gjitha hapat e procesit në sistem. Rolet Përgjegjës, Drejtor, Titullar, Pritës dhe Monitorues, të cilat janë në sistem nuk përdoren nga punonjësit përkatës sipas funksionit që secili prej tyre ka. Kjo praktikë bën që i gjithë procesi të realizohet nga roli specialist, duke rritur ndjeshëm riskun e mbivendosjes së attributeve dhe të drejtave të aksesit në sistem, si dhe duke cenuar ndarjen e nevojshme të përgjegjësisë.

- Komisionet përgjegjëse për kryerjen e vlerësimeve, sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të QKK-së, nuk aksesojnë drejtpërdrejt sistemet për të marrë dhe vlerësuar dokumentacionin e gjeneruar nëpërmjet tyre. Dokumentacioni u vihet në dispozicion nga specialisti i IT-së, i cili është i vetmi person i autorizuar nga titullari për të pasur akses në sistem, pavarësisht se nuk është pjesë e këtyre komisioneve, duke cënuar parimin e pavarësisë dhe transparencës së procesit të vlerësimit.
- Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023 ka përdorur sistemin e aplikimit online të projekteve të QKK [filmcoproduction.com](http://filmcoproduction.com), të cilin nuk e ka më në përdorim dhe nuk disponon kodin burim të tij. Kodi burim dhe i gjithë informacioni i ruajtur në të administrohet nga operatori, i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tij, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI. Gjithashtu, konstatohet se QKK nuk ka marrë masa në lidhje me marrjen e bazës së të dhënave që ky sistem përmban dhe që ka gjeneruar ndër vite që nga implementimi i këtij sistemi që prej vitit 2016 deri në vitin 2023, si dhe nuk ka dijeni të të dhënave që ky sistem ka disponuar për këtë periudhë kohore ku përfshihen të dhënat e aplikantëve që ky sistem kishte si psh., kontratat e financimit me QKK, skenari i filmit, marrëveshje me bashkë producent vendas dhe të huaj, lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre etj, të përcaktuara në rregulloret e QKK ndër vite.
- Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për ndjekjen e kërkesës së saj në lidhje me zhvillimin e një shërbimi në platformën e-Albania dhe nuk ka saktësuar informacionin e kërkuar nga AKSHI për implementimin e sistemit të aplikimeve online. Megjithëse AKSHI i ka vënë në dispozicion një server virtual, QKK nuk ka ndërmarrë masa për hostimin e aplikacionit web për sistemin e aplikimeve online të projekteve sipas kërkesave të vetë institucionit, duke vijuar kontratat me operatorin ekonomik pa përcaktuar vendndodhjen e hosting-ut dhe pa siguruar kontrollin administrativ mbi sistemin dhe të dhënat që ai përmban.
- Nga auditimi u konstatua se, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë ndodhen disa kopje të filmave të projekteve filmike të financuara nga QKK ndër vite, por jo të gjitha janë të aksesueshme, pasi lexueshmëria e tyre varet nga pajisjet me të cilat janë dorëzuar, duke vështirësuar procesin e dixhitalizimit dhe arkivimit. Gjithashtu, këto materiale nuk janë lënë në ngarkim të punonjësve specifikë për ruajtjen, menaxhimin si dhe pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Gjithashtu, konstatohet se vetëm një kopje e filmave të projekteve ruhet në NAS-in e QKK-së, në kuadër të backup-it, procedurë kjo e cila nuk është e dokumentuar apo pasqyruar në një akt administrativ.

#### ***Paraqitja e rekomandimeve kryesore:***

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie institucionale gjithëpërfshirëse, në të cilën të integrojë edhe komponentët e teknologjisë së informacionit, si një faktor mbështetës për përmbushjen e objektivave të saj. Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës për risqet, ku të përfshijë edhe elemente të Teknologjisë së Informacionit, me qëllim analizimin, vlerësimin e tyre dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.
- Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për përcaktimin dhe delegimin e qartë të lidhjes ndërmjet pozicionit të punës dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë si përdorues

i sistemeve AMS dhe SQDNE, ku secili përdorues të ketë akses për kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas funksionit të tyre.

- Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim marrjen e bazës së të dhënave për sistemin e aplikimit online të projekteve të QKK, si dhe kodit burim për këtë sistem, duke mundësuar arkivimin e dokumentacionit të ruajtur në të, importimin e të dhënave të ruajtura në sistem për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshmërisë së të dhënave të aplikimeve që janë kryer ndër vite në QKK. Gjithashtu të sigurohet që pas transferimit, këto të dhëna nuk ruhen tek Operatori Ekonomik në kushtet kur pjesë e tyre janë dhe të dhëna personale të cilat mbrohen me ligj.

- Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për vazhdimin dhe finalizimin e zhvillimit të shërbimit online për aplikimet për mbështetje financiare të projekteve në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit, me qëllim përmbushjen e objektivave institucionale dhe zbatimin e kërkesave ligjore për ofrimin e shërbimeve vetëm në mënyrë elektronike.

- Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa të menjëhershme për caktimin e personave përgjegjës për menaxhimin e filmave të dorëzuar në QKK, për çdo projekt filmik të financuar ndër vite.

Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave specifike dhe procedurave të standardizuara që garantojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe vazhdimësinë e përdorimit të këtyre materialeve.

### **3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit**

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300, Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 5310, Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, bazuar në gjetjet e auditimit, evidencat e mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2024, vlerësojmë se mungesa e kontrolleve dhe mekanizmave të duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT, si dhe mungesa e akteve rregullatore dhe mos delegimi i përgjegjësive për veprimet e kryera në drejtim të sistemit të aplikimit online të projekteve që QKK ka investuar ndër vite, kanë ndikuar negativisht në zhvillimin dhe monitorimin efektive të aktivitetit të institucionit. Aktualisht QKK nuk ka ndërmarrë masa për të informatizuar procesin e aplikimeve online të projekteve duke qenë se sistemi që kanë përdorur është hequr nga përdorimi. Gjithashtu, QKK nuk ka marrë masa në lidhje me marrjen e bazës së të dhënave që është gjeneruar ndër vite për aq kohë sa është përdorur që nga implementimi i sistemit i cili ka gjeneruar këtë bazë të dhënash. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit janë të pamjaftueshëm, duke cënuar procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 1459/2, me datë 06.01.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.01.2025 deri më datë 21.02.2025, në subjektin “Qendra Kombëtare e Kinematografisë”, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.S, përgjegjës grupi;
2. A.K, audituese.

### 1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në QKK, nga data 08.01.2025 deri më datë 21.02.2025. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

*Objekti i Auditimit TIK* është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura.

*Qëllimi i Auditimit TIK* është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

### 2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 1459/2 Prot, datë 06.01.2025:

1. *Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*
2. *Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit*

### 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka si objekt të saj mbështetjen ekonomike, drejtimin dhe koordinimin e gjithë veprimtarisë kinematografike në Shqipëri. Veprimtaria kinematografike në kuptimin e lartëpërmendur përfshin krijimin, prodhimin, bashkëprodhimin, shpërndarjen dhe shfaqjen e veprave filmike, si dhe format e tjera të shfrytëzimit të punëve krijuese kinematografike.

### 4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi QKK mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që janë implementuar në sistemet informatike.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 1459/2 Prot., datë 06.01.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon institucioni nën auditim si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

## 5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

*Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 *“Për Kinematografinë”*, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*;
- VKM nr. 602, datë 21.08.2003 *“Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare Kinematografike”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, i ndryshuar;
- Rregulloret përkatëse të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, etj.

## 6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, si dhe ISSAI 5300 Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 100 Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, etj.

## 7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumentacioneve për sistemet informatike që institucioni disponon;
- Shqyrtimi i informacioneve dhe raporteve të institucionit në auditim;
- Intervista të zhvilluara me personelin kyç të QKK;
- Verifikimi dhe analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

## 8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) vepron si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për bashkërendimin e punës, mbështetjen financiare, nxitjen e veprimtarisë kinematografike në Republikën e Shqipërisë dhe për përfaqësimin e kinematografisë shqiptare në botë. QKK është institucioni më i rëndësishëm kombëtar që inkurajon, financoon dhe promovon prodhimin kinematografik në Shqipëri. Përmes administrimit të fondit publik, QKK mundëson zhvillimin e industrisë së filmit në vendin tonë.

Qëllimi i QKK-së është zhvillimi i kinematografisë duke inkurajuar vizionet e reja. QKK që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentar dhe të animuar.

QKK ofron mbështetje financiare për festivale filmi, organizon Ditë të Filmit Shqiptar në vende të tjera, si dhe seminare e konferenca që kontribuojnë në zhvillimin e industrisë së filmit në Shqipëri. QKK gjithashtu ndihmon edhe botimin e literaturës së artit filmik. QKK është përfaqësuese e Shqipërisë pranë strukturave ndërkombëtare kinematografike Eurimages, SEE Cinema Network dhe European Film Promotion dhe organizon pavione të filmit shqiptar në festivalet ndërkombëtare të filmit në Kanë dhe Berlin.

#### 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

##### 2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Në zbatim të pikës 1. “*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*” të Programit të Auditimit nr. 1459/2, datë 06.01.2025 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:


- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Lista e të gjithë punonjësve në IT sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë;
- Përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi;
- Urdhër i Kryeministrit nr. 5, datë 18.01.2012 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë*”;
- Rregullore e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë miratuar me Urdhër nr. 163, datë 22.05.2024;
- Rregullore e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë miratuar me nr. 57 prot., datë 27.01.2023;
- Rregullore e përgjithshme e mbështetjes financiare dhe lejeve miratuar me urdhër të Kryetarit të QKK nr. 168 prot., datë 27.05.2024;
- Rregullore e përgjithshme e mbështetjes financiare dhe lejeve miratuar me urdhër të Kryetarit të QKK nr. 60 prot., datë 27.01.2025;
- Regjistër risku si dhe planet e menaxhimit të tij për periudhën e audituar;
- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Etj.

##### Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

###### ➤ *Vlerësimi i Burimeve Njerëzore*

Për kryerjen e funksioneve institucionale Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 5, datë 18.01.2012 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë*” e cila është e ndërtuar mbi bazën e një Drejtorie dhe një Sektori përkatësisht si më poshtë:

Diagrama nr.1: Struktura e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë



Burimi: QKK, përpunuar nga grupi i auditimit

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë është gjithsej 9 punonjës nga të cilët 4 janë vende vakante. Detyrat specifike dhe përshkrimet e punës së punonjësve të QKK-ës janë pjesë përbërëse e Rregullores së brendshme me nr. 163 prot., datë 22.05.2024 “Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”.

Tabela nr.1: Organika e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë

Nr.	Pozicioni	Nr. i punonjësve		
		Plan	Fakt	Arsimimi
1	Kryetar	1	1	Kineast/Regjisor
<b>Drejtoria e Projekteve</b>				
2	Drejtor i Projekteve	1	-	-
3	Specialist, Jurist	2	-	-
4	Specialist, Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shtypin	1	1	Mësuesi e gjuhës angleze për shkollat e mesme
5	Arkivist	1	1	Menaxhere arti dhe arkiviste
<b>Sektori i Shërbimeve të Brendshme</b>				
6	Përgjegjës Sektori i Shërbimeve të Brendshme	1	-	-
7	Specialist, Inspektor për Projektet, Menaxher	1	1	Ekonomiste
8	Specialist Mbështetës	1	1	Informatikan

Burimi: QKK, përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas rregullores së brendshme me nr. 163 prot., datë 22.05.2024 “Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” Specialisti Mbështetës kryen funksionet dhe detyrat si më poshtë:

- ✓ Merr të gjitha masat e nevojshme teknike për garantimin e kushteve normale të punës së punonjësve të QKK;
- ✓ Administron dhe përditëson faqen zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale të QKK;
- ✓ Mirëmban rrjetin dhe pajisjet kompjuterike të QKK, evidenton gjendjen dhe kushtet teknike të tyre dhe kur verën nevoja për shërbime raporton tek përgjegjësi i sektorit;
- ✓ Administron dhe mirëmban pajisjet dhe aparaturat e vizionimit të filmave të QKK;
- ✓ Realizon nga pikëpamja teknike shfaqjen e filmave për Komisionin e Vizionimit dhe mbikëqyr shfaqjen e filmave premierë, për festivale dhe javë filmi, që organizohen nga QKK;
- ✓ Evidenton nevojat për shërbime të ndryshme të institucionit dhe stafit;
- ✓ Kryen çdo detyrë tjetër për të cilën ngarkohet me urdhër / vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

Nga auditimi konstatohet se punonjësi i cili mbulon fushën e teknologjisë së informacionit në lidhje me emërtimin e pozicionit si specialist mbështetës bënë detyra shtesë të cilat nuk i ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të QKK konkretisht:

Me anë të shkresës nr. 432 prot., datë 13.11.2024 QKK i drejton AKSHI-t kërkesë për zëvendësimin e nëpunësit të autorizuar për përdorimin e sistemeve AMS dhe SQDNE. Ku për arsye riorganizimi të kuadrit të QKK kërkon nga AKSHI revokimin e aksesit të ish nëpunësit

që kishte akses në AMS dhe SQDNE dhe autorizon specialistin mbështetës për administrimin e AMS dhe SQDNE për QKK. Detyrë kjo e cila sipas rregullores së QKK i përket specialistit juristit për ta kryer.

Me urdhrin nr. 132, datë 28.03.2014 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 5, datë 18.01.2012, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” ” emërtesa “ndihmëspecialist” është zëvendësuar me “arkivist”.

- Nga auditimi u konstatua se, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë punonjësi i cili merret me teknologjinë e informacionit ka emërtesën e pozicionit të tij si “Specialist Mbështetës”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

Me shkresën nr. 9 prot., datë 08.01.2025 është miratuar urdhri nr. 6 “Për ndryshimin e emërtesës së vendit të punës “specialist”, me kategorinë e pagës IV-3, në “sektorin e shërbimeve të brendshme””, ku emërtesa e vendit të punës specialist ndryshohet me emërtesën specialist IT.

Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” strukturat përgjegjëse TIK të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t.

Nga auditimi u konstatua se, struktura e TI në QKK nuk ka kaluar si pjesë e strukturës së AKSHI-t.

### ➤ **Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK**

Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

- Nga auditimi u konstatua se, QKK nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre.

Mungesa e një plani strategjik institucional të lidhur edhe me teknologjinë e informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme të cilat mund të mbështesin mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e objektivave të institucionit. Për sa më lart, QKK duhet të kishte marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e një strategjie mbi Teknologjinë e Informacionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale, ku duhet të përfshihet një plan mbi teknologjinë e informacionit dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret e institucionit, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikatat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka miratuar me Urdhër nr. 163, datë 22.05.2024 “Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, e cila ka si qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, duke përcaktuar rregullat mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillave të Miratimit të Projekteve, komisioneve të tjera që funksionojnë brenda dhe pranë QKK-së, strukturat e brendshme të saj duke përcaktuar edhe detyrat përkatëse.

- *Nga auditimi u konstatua se*, Teknologjia e Informacionit në QKK zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. QKK nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

#### ➤ **Trajnimet**

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë.

- *Nga auditimi u konstatua se*, QKK për periudhën objekt auditimi 2023-2024, nuk ka pasur plan trajnimi vjetor si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për burimet njerëzore të cilët mbulojnë fushën e teknologjisë së informacionit si dhe punonjës të cilët janë përdorues të pajisjeve dhe sistemeve teknologjike.

Nga auditimi nuk u administruan dokumentacione mbi propozimet përkatëse, për zhvillimin e trajnimeve specifike. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

#### ➤ **Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK**

Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuara, monitorimit të rreziqeve të identifikuara më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i institucionit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në QKK.

- *Nga auditimi u konstatua se*, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk disponon regjistër rrishtu, ku të përfshihen dhe risqet e teknologjisë së informacionit, në asnjë formë nuk rezultojnë të jenë dokumentuar risqe të identifikuara për periudhën e audituar. Kjo në kundërshtim me nenin 11, pika 2: “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.*”, 12 pika 3/d: “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*” si dhe nenin 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve*”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”, QKK duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

## 2.2 Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 2 “*Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit*” janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemet informatike si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre si:

- Përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së informacionit në QKK;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;
- Aktet rregullative që lidhen me sistemet;
- Informacion mbi veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara;
- Vizita në terren;
- Indikatorë dhe statistika, etj.
- Skema e komunikimit të network-ut;
- Politikat mbi Sigurinë e Informacionit;
- Verifikimi i dokumenteve të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat;
- Konsultim me faqen e web-it të QKK, etj.

Ndër detyrat kryesore të QKK është regjistrimi i të gjithë personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes së filmave sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, si dhe pajis me certifikatë për ushtrimin e këtyre veprimtarive të gjithë aplikantët që plotësojnë kushtet e nevojshme të përcaktuara në rregulloret në fuqi në bazë të të cilave funksionon QKK. Gjithashtu, regjistron të gjithë personat fizikë e juridikë që zotërojnë sallat e mjedise të tjera për shfaqjen e veprave filmike, sipas rregullores së shpërndarjes dhe shfaqes së veprave filmike në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe regjistron filmat e realizuar ose të importuar që do të shfaqen në territorin e Shqipërisë.

Aktualisht, QKK ofron katër shërbime online, të tipit biznes, nëpërmjet platformës E-Albania, konkretisht:

### 1. Aplikim për regjistrimin vjetor të Producentëve

Ky shërbim u mundëson të gjithë personave juridikë dhe fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shpërndarjes së filmave, të bëjnë regjistrimin vjetor të Producentit. Producent i një veprë filmike është një person ose grup personash fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që organizon e mbështet ekonomikisht dhe merr përgjegjësinë për realizimin e veprës filmike me ose pa fond buxhetor. Ai gëzon të drejtën e shfrytëzimit ekonomik mbi veprën filmike të realizuar. Qendra Kombëtare e Kinematografisë kryen regjistrimin vjetor të subjekteve juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shpërndarjes së filmave.

Baza ligjore: Neni 4, pika 7, Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

### 2. Aplikim për regjistrimin vjetor të Distributorëve/Difuzorëve

Ky shërbim u mundëson të gjithë personave juridikë dhe fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e shpërndarjes së filmave, të bëjnë regjistrimin vjetor të Distributorit/Difuzorit. Distributor/Difuzor është personi fizik ose juridik apo një grup personash fizikë a juridikë, apo një ndërthurje e tyre, vendas ose të huaj, që realizon për qëllime përfitimi ekonomik tregtimin ose shpërndarjen e veprës filmike. Qendra Kombëtare e Kinematografisë kryen regjistrimin vjetor të subjekteve juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e shpërndarjes së filmave.

Baza ligjore: Neni 4, pika 8, Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

### 3. Aplikim për konfirmim financimesh për projektet e miratuara

Ky shërbim mundëson aplikimin për konfirmimin e financimit për projektet e miratuara nga Këshilli i Miratimit të Projekteve, i cili nevojitet për sigurimin e bashkëprodhimeve për realizimin e projekteve filmike.

Kryerja e këtij shërbimi është detyrë ligjore e përcaktuar në Rregulloren për Financimin të QKK-së, si dhe ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

### 4. Aplikim për pajisje me leje qarkullimi filmat që shfaqen në territorin e Republikës së Shqipërisë

Ky shërbim u mundëson të gjithë personave juridikë dhe fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e shpërndarjes së filmave, të aplikojnë për pajisje me leje qarkullimi për filmat që shfaqen në territorin e RSH. Komisioni i Vizionimit pajis me leje për qarkullim veprat filmike të krijuara brenda territorit të Shqipërisë ose të importuara nga jashtë. Distributori që dëshiron të marrë licencën e qarkullimit duhet të paraqesë kopjen e filmit në format elektronik. Kopja e filmit duhet të jetë e njëjtë në gjatësi dhe cilësi me kopjen që do të qarkullojë. Për pajisjen me Leje qarkullimi, distributori është i detyruar të përgatisë për qarkullim filmin të dubluar ose të substituar në gjuhën shqipe.

Baza ligjore: Neni 4, pika 9, i ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

Shërbimet që gjenden në URL-të e mësipërme, janë zhvilluar nga AKSHI, nëpërmjet nënkontraktimit, dhe menaxhohen teknikisht prej saj. Ato përdorin sistemin standard AMS/SQDNE, i cili, përdoret për trajtimin e kërkesave dhe përgjigjeve në sistem.

Pranë QKK funksionojnë këto këshilla dhe komisione:

1. Këshillat e Miratimit të Projekteve (KMP);
2. Komisioni Përzgjedhës i Leximit (KPL);
3. Komisioni Financiar;
4. Komisioni i Vizionimit;
5. Komisioni i Monitorimit të Projekteve;
6. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve.

Detyra kryesore e KMP-ve është vlerësimi i projekteve kinematografike nga pikëpamja artistike e ekonomike, si dhe përzgjedhja e projekteve mbi bazë meritokracie, duke garantuar përzgjedhjen e projekteve kinematografike që sigurojnë cilësinë dhe administrimin e fondeve publike. Ndër detyrat e tjera të KMP-vë është dhe disponimi i materialeve të projekteve që do të shqyrtohen të paktën 10 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.

Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve i cili përbëhet nga Drejtori i Drejtorisë së Projekteve, Specialisti i Projekteve dhe Juristi i QKK ka detyrë shqyrtimin dhe përzgjedhjen nga ana administrative të projekteve kinematografike që depozitohen për konkurim.

Projektet e paraqitura për konkurim në rrjet shkarkohen brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar për depozitim të projekteve.

Në zbatim të rregullores së brendshme miratuar me nr. 163 prot., datë 22.05.2024, specialisti Jurist i cili është dhe pjesë e këtij komisioni ka për detyrë administrimin e sistemeve SQDNE dhe AMS për shërbimet në rrjet që ofron QKK në e-albania.

Komisioni i Vizionimit pajis me Leje Qarkullimi veprat filmike, që paraqiten nga distributorët për t'u pajisur me Leje Qarkullimi.

Marrëdhëniet e QKK me producentët/Shtëpitë Kinematografike, Distributorët, Difuzorët dhe Sallat e Kinemave

❖ Regjistrim në QKK

Producentët, distributorët, difuzorët dhe sallat e shfaqjes publike (kinematë) regjistrohen në QKK çdo vit kalendarik. Producenti duhet të ketë kryer procedurën e regjistrimit kur fillon marrëdhëniet financiare me QKK.

Dokumentacioni që duhet të ngarkojnë aplikantët në platformën e-Albania:

1. Producentët që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-Albania:
  - a) Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në QKK;
  - b) Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit;
  - c) Jetëshkrimin e kërkuesit;
  - d) Diplomë në fushën e kinematografisë, audiovizualit ose shkencave ekonomike e financiare;
  - e) Të paktën dy letra rekomandimi nga producentët me përvojë;
  - f) Të paktën dy kontrata pune në cilësinë e asistentit të produksionit;
  - g) Ekstrakt historik nga QKB.
2. Distributorët dhe difuzorët që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-Albania:
  - a) Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në QKK;
  - b) Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit;
  - c) Diplomë të arsimit të lartë;
  - d) Jetëshkrimin e kërkuesit;
  - e) Ekstrakt historik nga QKB;
  - f) Fotokopje të licencës së AMA për difuzorët.
3. Sallat e shfaqjes publike (kinematë) që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-Albania:
  - a) Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në QKK;
  - b) Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit;
  - c) Jetëshkrimin e kërkuesit;
  - d) Diplomë të arsimit të lartë;
  - e) Ekstrakt historik nga QKB.
4. Producentët, distributorët, difuzorët dhe sallat e shfaqjes publike (kinematë) që regjistrohen periodikisht për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-Albania:
  - a) Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit periodike në QKK;
  - b) Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit.

Për tu pajisur me leje xhirimi produksionet (vendase apo të huaja) duhet të paraqesin në QKK dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për pajisje me leje xhirim;
- b) Sinopsis të projektit filmik;
- c) Ekstrakt të kompanisë së Produksionit dhe CV të saj;
- d) Informacion për bashkë producentët e projektit filmik (në rast se ka);
- e) Përshkrim i vendeve ku do të kryhen xhirimet;
- f) Plani kalendarik i xhirimeve;
- g) Informacion ku të përshkruhen nevojat për mbështetje nga strukturat publike si Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Autoritetet vendore, etj., për vënien në dispozicion për xhirime të objekteve të ndryshme, rekuizitë, materiale piroteknike, armatim për përdorim filmik, kostume, uniforma, personel, etj.

Në lidhje me sistemin AMS dhe SQDNE sipas email-eve përkatës AKSHI vendos në dijeni QKK që është mbyllur aksesit për ish nëpunësin dhe është hapur useri për specialistin mbështetës. Gjithashtu në komunikimet me e-mail AKSHI bënë me dije në lidhje me rolet që ekzistojnë për dy sistemet përkatëse AMS dhe SQDNE, përkatësisht:

## Rolet në sistemin AMS

Specialist – ky rol kryen shqyrtimin e aplikimeve dhe hartimin e përgjigjes;

Përgjegjës – ky rol në varësi të workflow që mund të ketë institucioni, mund të jetë dhe në rolin pritës, çdo përgjigje e hartuar nga specialisti dërgohet për miratim te përgjegjësi.

Drejtor – ky rol pret aplikime për miratim, vetëm përdoruesit në rol përgjegjësi mund të dërgojnë aplikime për miratim në këtë rol.

Titullar – ky rol pret aplikime për miratim, vetëm user-at në rolin Drejtor mund të përcjellin për miratim aplikimet në këtë rol.

Pritës – ky rol pret aplikimet e ardhura në AMS, zakonisht konfigurohet përgjegjësi që më pas bën delegimin te specialistët.

Monitorues – ky rol bën monitorimin e aplikimeve në çdo hallkë që kalon, por nuk ka të drejtë të kryejë asnjë veprim mbi aplikimet. Zakonisht në këtë rol konfigurohen titullarët e institucioneve.

## Rolet në sistemin SQDNE

Specialist - ky rol ka për detyrë kontrollin e gjithë aplikimeve të ardhura nga qytetarët/bizneset drejt institucionit tuaj. Pas përgatitjes së dokumentave, roli specialist ngarkon në sistem përgjigjen për aplikantin që ka bërë kërkesën.

Institucion Mendimdhënës - Ky rol ka për detyrë kontrollin e gjithë kërkesave të ardhura nga institucione të tjera drejt institucionit tuaj për dokumente shoqëruese. Pas përgatitjes së dokumentave, roli pritës ngarkon në sistem përgjigjen për institucionin që ka bërë kërkesën.


Titullar - Ky rol ka për detyrë të nënshkruajë elektronikisht kërkesat për dokumentet shoqërues dhe të dërgojë nëpërmjet SQDNE tek punonjësi që ka bërë kërkesën për atë dokument.

Monitorues - Ky rol ka për detyrë monitorimin e informacione statistikore rreth aplikimeve.

*Nga auditimi konstatohet se, QKK për sistemet AMS dhe SQDNE përdor vetëm rolin specialist për të gjitha hapat e procesit në sistem. Rolet Përgjegjës, Drejtor, Titullar, Pritës dhe Monitorues nuk i përdor, të gjithë procesin e realizon roli specialist duke rritur riskun e mbivendosjes së atributeve dhe të drejtave në sistem.*

*Nga auditimi konstatohet se, komisionet të cilat bëjnë vlerësimet përkatëse sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të QKK nuk kanë akses në sistem dhe dokumentacioni që gjenerohet nëpërmjet këtij sistemi u vendoset në dispozicion nga specialisti i IT i cili është i vetmi që ka akses në sistem pavarësisht se nuk është pjesë e këtyre komisioneve.*

❖ Sistemi AMS aksesohet nga QKK nëpërmjet SharePoint të vendosur në dispozicion nga AKSHI dhe përbëhet nga sesionet si më poshtë:



*Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit AMS u konstata se:*

- Nuk ka rregullore për përdorimin e modulit të AMS për QKK, punonjësit të cilët merren me përdorimin e tij i referohen disa tutorialeve që i janë vendosur në dispozicion nga AKSHI, ku

nga verifikimi i tyre u konstatua se i përkasin modulit AMS për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH);


- Gjatë përdorimit të këtij sistemi ka vonesa të vazhdueshme në procesin e shqyrtimit të aplikimeve nga specialisti përgjegjës për QKK;
- Ekzistojnë rekorde testimi nga operatori të cilat shfaqen në sistemin live si më poshtë:

Title	Data e Krijimit	Alatë / Përfundimit	Numeri i Aplikimit	Statusi i Aplikimit	Statusi i Brevdoshëm / Apli. NID	Emri i Aplikantit	Telefon	Ohuesi / Shërbimit
Emri Mbllesi 07-12-2020	12/17/2020 3:44 PM	1/20/2021	MK-2020-2188402-LI	Refuzuar	Aprovuar	numer personal	Emri Mbllesi	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 11-12-2020	12/11/2020 12:43 PM	1/25/2021	MK-2020-4261134-SU	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 11-12-2020	12/11/2020 12:43 PM	1/25/2021	MK-2020-4293814-CM	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 11-12-2020	12/17/2020 3:19 PM	1/28/2021	MK-2020-5689180-RG	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 30-12-2020	12/30/2020 2:53 PM	2/10/2021	MK-2020-4464762-40E	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 30-12-2020	12/29/2020 5:31 PM	2/10/2021	MK-2020-3310245-VM	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 14-01-2021	1/14/2021 2:22 PM	2/25/2021	MK-2021-8252522-NG	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 14-01-2021	1/14/2021 2:32 PM	2/25/2021	MK-2021-8419029-UV	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 19-01-2021	1/19/2021 2:13 PM	3/2/2021	MK-2021-2487005-AJ	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 11-02-2021	2/11/2021 4:06 PM	3/25/2021	MK-2021-8948367-GU	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE
SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION 15-02-2021	2/15/2021 12:50 PM	3/26/2021	MK-2021-4332220-WD	Refuzuar	Aprovuar	L11328009F	SOFT & SOLUTION SOFT & SOLUTION	REGISTRIMIN VIETOR TE PRODUCENTEVE

- Ekzistojnë rekorde të cilat i përkasin të njëjtit aplikues dhe nuk shfaqen tek Aplikimet e dubluara, si më poshtë:

Title	Data e Krijimit	Alatë / Përfundimit	Numeri i Aplikimit	Statusi i Aplikimit	Statusi i Brevdoshëm / Apli. NID	Emri i Aplikantit	Telefon	Ohuesi / Shërbimit
[Empty Table Content]								

- Tek aplikimet e Refuzuara ekzistojnë rekorde testimi nga operatori;
- Tek aplikimet e Përfunduara dalin të gjitha aplikimet e bëra edhe nëse aplikimi është refuzuar



ose është i dubluar;

- Aplikanti mund të bëjë disa aplikime për një shërbim të caktuar duke upload-uar dokumentat e njëjta. Këto raste dalin të gjitha në sistem dhe pse janë të dublikuara për të njëjtin aplikant. Nuk është e mundur që nëse aplikimi i parë është bërë gabim të vazhdojë procedura sërish tek i njëjti rekord duke shmanget dublikimet;
- Për shërbimet e ofruara nuk është i mundur gjenerimi i statistikave;
- Aplikimet të cilat janë trajtuar brenda afatit dalin tek sesioni jashtë afatit, duke mos bërë një raportim të saktë në lidhje me trajtimin e aplikimeve përkatëse.

❖ Sesionet e konkurimit për projekte kinematografike hapen si rregull një herë në vit, në raste të veçanta dhe në varësi të situatës financiare mund të hapen thirrje të tjera. Hapja e konkurseve shpallet publikisht dhe i njoftohen producentëve dhe kineastëve në faqen zyrtare të QKK, në Buletinin Zyrtar të Kinematografisë, si dhe në mjetet e tjera të komunikimit elektronik.

#### Paraqitja e Projektit për Konkurim:

*Nga auditimi konstatohet se, bazuar në Kreun V, pika III.1 “Paraqitja e Projektit për Konkurim” e Rregullores së përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve, miratuar me nr. 168 prot., datë 27.05.2024, citohet se: “Producentët paraqesin projektet për konkurim në rrugë elektronike, në faqen e internetit e-Albania. Deri në aktivizimin e shërbimeve në e-Albania aplikimet do të kryhen në rrugë elektronike përmes adresës email [info@qkk.gov.al](mailto:info@qkk.gov.al). Dokumentat e aplikimit ngarohen vetëm me lidhje (link) në platformat e specializuara WeTransfer, MyAirBridge ose SwissTransfer.”*

Gjithashtu, edhe me përditësimin e kësaj rregullore me nr. 60 prot., datë 27.01.2025 “Rregullore e përgjithshme e Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” përcaktohet se producentët paraqesin projektet për konkurim në rrugë elektronike, në faqen e internetit e-Albania. Deri në aktivizimin e shërbimeve në e-albania aplikimet do të kryhen në rrugë elektronike përmes adresës email [info@qkk.gov.al](mailto:info@qkk.gov.al). Dokumentat e aplikimit ngarkohen vetëm me lidhje (link) në platformat e specializuara WeTransfer, MyAirBridge ose SwissTransfer.

*Nga auditimi konstatohet se, në rregulloren e sipërcituar janë lënë terma të cilat mund të sjellin konfuzion për aplikantët pasi aktualisht QKK nuk disponon asnjë sistem të mirëfilltë për paraqitjen e projekteve për konkurim, kjo pasi, bazuar në Kreun V, pika III.2 e “Rregullore e përgjithshme e Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” citohet se: “Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve do të skualifikojë projektet që nuk paraqesin (ngarkojnë në sistem) të gjithë dokumentacionin e përcaktuar “I detyrueshëm”, apo që paraqesin (ngarkojnë në sistem) dokumenta të pavlefshme”, si dhe në*

pikën III.4 citohet se “Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve (KSHPP), konform procedurës me të cilën operon, vendos për projektet që janë paraqitur (ngarkuar në sistem) në mënyrë korrekte, të cilët do të kalohen për shqyrtim në KMP”.

Për projektet e shpallura fituese nga KMP-të, producenti duhet të dorëzojë dokumentacionin origjinal pranë Drejtorisë së Projekteve të QKK përpara nënshkrimit të kontratës së financimit.

Nga auditimi konstatohet se, QKK ka pasur më parë në përdorim sistemin e aplikimit online të projekteve të QKK [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com), e cila aksesohet në adresën <https://filmcoproduction.com> dhe përdoret për regjistrimin e producentëve dhe distributorëve, si dhe paraqitjen e dokumentacionit të projekteve të tyre kinematografike për të aplikuar pranë QKK-së.

Nga auditimi konstatohet se referuar shkresës nr. 178, datë 05.04.2023 miratuar nga ish Kryetari i QKK me lëndë “Njoftim drejtuar producentëve / shtëpive kinematografike”, afati i fundit i depozitimit të projekteve nëpërmjet këtij sistemi ka qenë data 05.05.2023 e verifikuar kjo në faqen zyrtare të QKK <https://qkk.al/>.

Përdorimi i këtij sistemi ka qenë i specifikuar dhe tek rregulloret e brendshme të institucionit konkretisht: bazuar në Kreun VI, pika III.1 “Paraqitja e Projektit për Konkurim” e “Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, miratuar më nr. 57 prot., datë 27.01.2023, citohet se: “Producentët paraqesin projektet për konkurim në rrugë elektronike, në faqen e internetit [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com), që administrohet nga Qendra”.

Nga auditimi konstatohet se, sistemi i aplikimit online të projekteve të QKK [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com) nuk përdoret më për aplikimet dhe paraqitjen e projekteve për konkurim, gjithashtu konstatohet se ky sistem është inekzistent për QKK pasi i gjithë administrimi i tij qoftë software dhe hardware i është lënë kompanisë që e ka zhvilluar këtë sistem, si dhe nga ana e QKK nuk ka asnjë mundësi për aksesimin e dokumentacionit ndër vite të gjeneruar nëpërmjet këtij sistemi.

Konstatohet se QKK nuk ka marrë masa në lidhje me marrjen e bazës së të dhënave që ky sistem përmban dhe që ka gjeneruar ndër vite që nga implementimi i këtij sistemi që prej vitit 2016 deri në vitin 2023, si dhe nuk ka dijeni të të dhënave që ky sistem ka disponuar për këtë periudhë kohore ku përfshihen të dhënat e aplikantëve që ky sistem kishte si psh., kontratat e financimit me QKK, skenari i filmit, marrëveshje me bashkë producent vendas dhe të huaj, lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre etj të përcaktuara në rregulloret e QKK ndër vite.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se nga dokumentacioni i kërkuar dhe pyetësorët e zhvilluar në QKK grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion, urdhër apo ndonjë akt tjetër i miratuar për mos përdorimin më të këtij sistemi për aplikimin online të projekteve. Kjo faqe është tashmë offline. Në rregulloren e përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve, miratuar me nr. 60 prot., datë 27.01.2025 të QKK nuk është përcaktuar më aplikimi nëpërmjet sistemit por është përcaktuar që aplikimi do të realizohet nëpërmjet email-it. Për këtë ndryshim nuk ka një relacion në të cilin të sqarohet përse ky sistem është zëvendësuar me email-in si dhe nuk ka një informacion në lidhje me vazhdimësinë e tij pavarësisht se ky sistem ka qenë funksional.

#### Historiku i zhvillimit sistemit të aplikimit online të projekteve të QKK rezulton si më poshtë:

Për këtë sistem përkatësisht janë realizuar kontratat:

- Në vitin 2015 është lidhur kontrata nr. 715 prot., datë 01.12.2015 ndërmjet QKK dhe operatorit ekonomik D., objekti i kontratës është rregullimi i marrëdhënieve të palëve kontraktuese për realizimin e fazës së parë të projektit “Informatizimi i procedurave të aplikimit

të projekteve kinematografike në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë” me vlerë totale 874,000 (tetëqindeshtatëdhjetë e katër mijë) Lekë me TVSH.

Për sa më sipër është kryer pagesa me tre këste në vlerë 655,333.33 lekë pa TVSH, kësti i tretë nuk rezulton të jetë paguar nga QKK.

- Në vitin 2017 është lidhur kontrata me nr. 16/1 prot., datë 11.07.2017 me objekt “Objekti i kësaj kontrate do të jetë ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes e teknologjisë për përfituesin e shërbimit, që konsistojnë në:

- Shërbime mirëmbajtje dhe menaxhimi të sistemit dhe rrjetit kompjuterik (PC, printera, skanera, etj.);

o Windows Domain network;

o PC management;

- Marrja në dorëzim e software [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com);

- Azhurnimi dhe mirëmbajtja e kësaj faqeje;

- Shërbime lidhur me sigurinë e rrjetit kompjuterik;

- Komunikimi me AKSHI-n për azhurnimin e materialeve;

- Shërbime në media sociale.

Vlera e kontratës është 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH.

Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 22.08.2017 me faturë tatimore nr. 10, datë 21.08.2017 në vlerën 99,000.00 lekë pa TVSH dhe 118,800 lekë me TVSH.

Kjo kontratë është lidhur në mbivendosje me kontratën nr. 715 prot., datë 01.12.2015 ndërmjet QKK dhe operatorit ekonomik D., i cili nuk kishte përfunduar akoma fazën e mirëmbajtjes së këtij sistemi.

Për këtë nuk ka asnjë dokumentacion në të cilën të jepen arsyet e kësaj mbivendosje kontratash për të njëjtin sistem aplikimi.

- Në vitin 2018 është lidhur kontrata me nr. 283 prot., datë 05.06.2018 me objekt “Objekti i kontratës është shërbim mirëmbajtje dhe menaxhim i sistemit të faqes [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com), në të cilën kryhen aplikimet on line të projekteve kinematografike, që shqyrtohen nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.”

Vlera e kontratës është në vlerën 90.000 (nëntëdhjetëmijë) lekë pa TVSH dhe 108,000.00 lekë me TVSH.

Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 31.12.2018 me faturë tatimore nr. 1086, datë 26.12.2018 në vlerën 90,000.00 lekë pa TVSH dhe 94,000.00 lekë me TVSH.

- Në vitin 2019, është zhvilluar procedura me objekt “Ndryshime në sistemin e aplikimit on linë të QKK” me vlerë 100,000 lekë pa TVSH”. Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 12.09.2019 me faturë tatimore nr. 826, datë 16.08.2019 në vlerën 100,000 lekë pa TVSH dhe 120,000 lekë me TVSH.

Për këtë shërbim nuk është lidhur asnjë kontratë shërbimi.

- Në vitin 2020 është lidhur kontrata në datë 26.04.2020 me objekt “Objekti i kontratës është shërbim mirëmbajtje dhe menaxhim i sistemit të faqes [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com), në të cilën kryhen aplikimet on line të projekteve kinematografike, që shqyrtohen nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.”

Vlera e kontratës është në vlerën 90,000 (nëntëdhjetëmijë) lekë pa TVSH.

Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 03.06.2020 me faturë tatimore nr. 411, datë 26.05.2020 në vlerën 90,000.00 lekë pa TVSH dhe 108,000.00 lekë me TVSH.

- Në vitin 2022 është zhvilluar procedura me objekt “Shërbim mirëmbajtje dhe up-date [filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com) për vitin 2022” me vlerë 99,000 lekë pa TVSH. Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 25.11.2022 me faturë tatimore nr. 2422/2022, datë 24.11.2022 në vlerën

99,000.00 lekë pa TVSH dhe 120,000.00 lekë me TVSH. Për këtë shërbim nuk është lidhur asnjë kontratë shërbimi.

- Viti 2023. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se QKK ka realizuar procedurën me vlerë të vogël me objekt “Ndryshime dhe përditësime në sistemin e aplikimit on line të QKK”.

- Me datë 16.02.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 4, datë 16.02.2023 për prokurimin me vlerë të vogël nga Drejtori i Drejtorisë së Projekteve, pa numër protokolli. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Ndryshime dhe përditësime në sistemin e aplikimit on line të QKK”. Ku ndryshimet do konsistojnë në kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

1. Up-date i dokumentave të të gjitha projekteve;
2. Up-date i kërkesave të detyrueshme të të gjitha projekteve (shqip&anglisht);
3. Testimi i gjithë sistemit të aplikimit.

- Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 02.03.2023 me faturë tatimore 459/2023 në vlerën 50,000.00 lekë pa TVSH dhe 60,000.00 lekë me TVSH. Për këtë shërbim nuk është lidhur asnjë kontratë shërbimi.

Nga auditimi u konstatua se për çdo procedurë për këtë sistem që nga implementimi deri në mirëmbajtje / zhvillime të mëtejshme nuk rezulton të jenë marrë në dorëzim nga komisionet e blerjeve me vlerë të vogël shërbimet përkatëse në lidhje me sistemin e aplikimit on line të QKK [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com) në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për vitin 2018 dhe 2022 mirëmbajtja nuk është bërë sipas afateve të përcaktuara në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i cili parashikon se çdo institucion i cili ka një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbim për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim dhe shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike duhet të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Bazuar në pikën 2/b të këtij Vendimi përcaktohet se, institucionet të cilat kanë sisteme ekzistuese duhet të parashikojnë këtë marrëveshje për mirëmbajtjen e sistemeve dhe kohëzgjatja e saj nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

Për vitet 2017, 2019, 2021, 2023 konstatohet se sistemi ka qënë pa mirëmbajtje dhe suport nga asnjë operatorë dhe personat ndjekës të kontratës nuk kanë pasur njohuritë dhe kapacitetet profesionale për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi, duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimeve dhe vazhdimësinë e punës për këtë sistem.

*Nga auditimi u konstatua se,* investimi i bërë që nga implementimi deri në momentin që ky sistem është offline shuma e investuar për të kap vlerën 1,407,200 lekë me TVSH shumë kjo e llogaritur nga faturat e paguara nga QKK, pasi në kontabilitetin e QKK nuk ka një vlerë kontabël të regjistruar për këtë sistem.

Grupi i auditimit nga gjithë dokumentacioni i vendosur në dispozicion në lidhje me procedurat që është përfutur sistemi i aplikimit online nuk arrin të marrë siguri të arsyeshme mbi këto dokumenta për sa kohë që nuk plotësojnë kushtet e një dokumenti zyrtar, në mungesë të plotë të ekstremiteteve.

Me shkresën nr. 257 prot., datë 14.05.2019 QKK i drejton kërkesë për server virtual të dedikuar (VPS) AKSHI-të. Nëpërmjet kësaj shkrese QKK kërkon të hostojë aplikacionin web të zhvilluar nga D., në serverat e AKSHI-të të dedikuar nën subdomainin xx.xx.gov.al. Bashkëlidhur kësaj shkrese ka dërguar dhe formularin për “Kërkesë për Server Virtual të Dedikuar (VPS)”. Gjithashtu kërkon nga AKSHI edhe asistimin teknik dhe administrativ për kryerjen e transferimit (migrimit) prej serverave të D. drejt serverave të AKSHI-të.

Me shkresën nr. 2514/1 prot., datë 30.05.2019 AKSHI kthen përgjigje mbi kërkesën për server virtual të dedikuar, si dhe bën me dije QKK-në që është krijuar server virtual sipas specifikimeve të përcaktuara nga QKK.

Nga auditimi u konstatua se, QKK nuk ka marrë asnjë masë për hostimin e aplikacionit web tek AKSHI dhe ka vazhduar lidhjen e kontratave me D. të cilit në vijimësi nuk i ka përcaktuar vendin se ku do të hostohej aplikacioni web së bashku me database-in e tij, duke i' a lënë kështu operatorit ekonomik të drejtat administrative mbi këtë sistem pa pasur asnjë informacion vetë QKK-ja.

**- Mbi kodin burim:**

Nga auditimi konstatohet se QKK për sistemin e aplikimit online të projekteve të QKK [www.filmcoproduction.com](http://www.filmcoproduction.com) që ka investuar ndër vite nuk disponon kodin burim. Kodi burim dhe i gjithë informacioni i ruajtur në të administrohet nga operatori i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tij, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI.

Me anë të shkresës nr. 345 prot., datë 26.09.2024 QKK i drejton AKSHI-t kërkesë për zhvillimin dhe shtimin e një shërbimi të ri në platformën e-Albania për QKK.

Nëpërmjet këtij shërbimi QKK synon që t'u mundësohet kineastëve, të regjistruar si persona fizik ose juridik, që të aplikojnë për mbështetjen financiare me projektet e tyre në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit duke aplikuar online. Gjithashtu, i kërkon AKSHI-t zhvillimin (development) e këtij shërbimi si dhe bashkëlidhur shkresës i ka vendosur në dispozicion dhe dokumentat përkatës në lidhje me:

- Formularin standard të aplikimit për shtimin e një shërbimi të ri në platformën e-Albania;
- Workflow-n e procesit administrativ të aplikimit;
- Shënime sqaruese lidhur me procesin administrativ të aplikimeve.

Gjithashtu, QKK pretendon se sistemi që ai vetë parashikon, të realizohet i gjithi në sistemin SQDNE.

Me anë të shkresës nr. 4663/1, datë 05.11.2024 protokolluar nga AKSHI dhe nr. 345/1, datë 06.11.2024 protokolluar në QKK, i kthen përgjigje QKK duke e bërë me dije se Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) është sistemi i cili bën të mundur komunikimin, shkëmbimin e dokumentave shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës “e-Albania”, deri në lëvrimin e tij dhe lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e lëvrimin të shërbimit sipas afateve ligjore. Pritja dhe trajtimi i aplikimeve sipas proceseve të punës specifike të një institucioni bëhet nëpërmjet një sistemi elektronik të dedikuar, i cili duhet të cilësohet nga ana e QKK në këtë rast se çfarë sistemi do të jetë, nëse e disponojnë një të tillë. Nëse institucioni nuk disponon një sistem të dedikuar elektronik, duhet të merren masa për ngritjen e një sistemi i cili bën të mundur pritjen dhe trajtimin e aplikimeve duke përfshirë të gjithë hapat e punës deri në gjenerimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike.

Sistemi elektronik duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Të mundësojë pritjen e aplikimeve dhe procesimin e tyre;
- Të mundësojë një mënyrë gjurmimi të aplikimeve në proces;
- Të ketë një mënyrë postimi përgjigje/informim të aplikantit në momentin kur përfundon aplikimi dhe merret përgjigja përfundimtare.

AKSHI i kërkon QKK-së të përcjellë të saktësuar informacionet e kërkuara në mënyrë që të nisi procesin e implementimit të tij më pas në SQDNE.

*Nga auditimi u konstatua se, QKK nuk e ka vazhduar më tej saktësimin e informacionit të kërkuar nga AKSHI në lidhje me krijimin e një sistemi të dedikuar apo implementim në sistem ekzistues që QKK disponon në lidhje me procesin administrativ të aplikimeve. Gjithashtu, në korespondencën që QKK ka pasur me AKSHI-n në asnjë rast nuk ka bërë me dije këtij të fundit se ka pasur një sistem të mëparshëm nëpërmjet të cilit realizoheshin aplikimet për projektet kinematografike.*

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Z. E.Ç në cilësinë e Kryetarit aktual në QKK;
- 2) Z. E.M në cilësinë e ish Kryetarit të QKK;
- 3) Z. I.B në cilësinë e ish Kryetarit të QKK;
- 3) Znj. M.C në cilësinë e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
- 4) Znj. K.K në cilësinë e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël si dhe Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve;
- 5) Znj. Sh.D në cilësinë e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël si dhe Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve;
- 6) Z. A.L në cilësinë e personit të autorizuar të Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve;
- 7) Znj. E.Sh në cilësinë e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
- 8) Znj. M.T në cilësinë e Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve;
- 9) Znj. M.B në cilësinë e ish përgjegjëses së sektorit të shërbimeve të brendshme;
- 10) Znj. M.Z në cilësinë e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.

#### **- Active Directory**

QKK për menaxhimin e përdoruesve, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet nuk përdor Active Directory. Çdo pajisje kompjuterike në QKK është e lidhur lokalisht, jo në një rrjet të qendëruar. Në çdo PC, individualisht, që përdoret prej nëpunësve ka një user default të krijuar prej vetë Windows-it.

Ndërtimin logjik i rrjetit të brendshëm dhe aksesimit të tij zhvillohet në mungesë të konfigurimit me Domain Controller dhe aksesimit në rrjet nëpërmjet Active Directory, siguria në rrjetin e brendshëm është e rrezikuar për sa kohë nuk janë aplikuar për përdoruesit kufizime me impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë e të dhënave dhe informacionit që administrojnë QKK. Dokumentet, informacionet që krijohen dhe përpunohen nga çdo pozicion pune nevojitet të ruhet lokalisht, pasi konfigurimet aktuale nuk e bëjnë të mundur ruajtjen e tyre në një server të dedikuar.

#### **➤ Vazhdimësia e ofrimit të shërbimit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat**

Me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash, nevojitet të hartohen plane të rikuperimit nga katastrofa, në të cilat dokumentohen masat dhe procedurat për rivendosjen në funksionim të sistemit me qëllim garantimin minimal të shërbimeve që ofrohen nëpërmjet sistemeve informatike, funksionet kritike, kohën e rikuperimit si dhe burimet njerëzore që përfshihen në rast emergjence.

*Nga auditimi u konstatua se, në QKK nuk janë:*

- Analizuar dhe përcaktuar sistemet, të dhënat konfidenciale të cilat i akseson në vazhdimësi apo përkohësisht sa herë është e nevojshme dhe në përputhje me aktivitetin e QKK-ës.
- Ndërtuar plane të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit si dhe plan të rimëkëmbjes në rast të një ndërprerje nga arsye të ndryshme që mund të jenë natyrore, njerëzore apo fizike.

#### **➤ Procedura e backup-it**

Një ekzemplar i filmave të projekteve filmike të financuara nga QKK të cilat dorëzohen në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dorëzohen gjithashtu edhe pranë Arkivit Qendror

Shtetëror të Filmit, në media të tilla si: external HDD, USB flash, DVD dhe/ose Blu-Ray, ku vetëm një kopje e këtyre të fundit ruhet në NAS-in e QKK-së, në kuadër të backup-it procedurë kjo e cila nuk është e dokumentuar apo pasqyruar në një akt administrativ.

Dokumentet e nëpunësve, të cilat, mbahen në PC e tyre bëhen backup automatikisht në OneDrive, hapësira prej 1 TB në OneDrive ofrohet nga AKSHI nëpërmjet account-eve të e-mail-it zyrtar, që ka secili nëpunës.

*Nga auditimi u konstatua se, në QKK ndodhen disa kopje të filmave të projekteve filmike të financuara nga QKK të sjella ndër vite të cilat jo të gjitha janë të lexueshme në varësi të pajisjes që është dorëzuar me qëllim dixhitalizimin dhe arkivimin e tyre si dhe nuk i ka askush në ngarkim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.*

### ➤ **Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve**

Objekti: Vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit të politikave dhe procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve.

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe komunikimi i brendshëm institucional si dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet TI që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nga punonjësit të mbështetjes i cili ka profil TI, nëpërmjet e-mail-eve, komunikimeve me celular apo shkëmbimeve verbale.

*Nga auditimi u konstatua se, institucioni nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI. Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që QKK të mos identifikojë dhe menaxhojë risqet me efekt negativ në TI dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim të trajtimit të gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e TI në QKK. Pasja e procedurave të dokumentuara për zbulimin dhe regjistrimin e incidenteve dhe problemeve ul riskun e aksesit të paautorizuar të përdoruesve edhe ndërhyrjet e paautorizuara, dështimeve të rrjetit, funksionalitetit të ulët të programeve (ofrimi i shërbimeve). Nisur nga rëndësia e procesit të menaxhimit të ndryshimit, i cili duhet të sigurojë që ndryshimet janë regjistruar, vlerësuar, autorizuar, prioritarizuar, planifikuar, testuar, implementuar, dokumentuar dhe rishikuar në përputhje me procedurat e dokumentuara dhe të aprovuara të menaxhimit të ndryshimit, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion. Nga intervistat e zhvilluara me personat përgjegjës në QKK, konstatohet se nuk disponohet procedurë për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisive për kryerjen e ndryshimeve në proceset e punës operacionale të QKK.*

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 119/2 prot., datë 25.04.2025 “Komente dhe shpjegime të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në lidhje me projekt-raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të vitit 2025, me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** ... Vlerësojmë se do të qe e dobishme për veprimtarinë e QKK-së, që, në projekt-auditimin të ishte shpjeguar më në hollësi «analiza e riskut», e realizuar prej kësaj të fundit, ndaj QKK-së...

Në fakt, në kohën kur është paraqitur shkresa e Kryetarit të KLSH-së, ku, QKK-ja informohet se do të auditohet, nuk ka pasur në administrimin e saj asnjë sistem të teknologjisë së informacionit, përveç sistemeve të shfrytëzimit (operating systems), Windows, të cilët, përdoren në çdo ordinator të saj.

...QKK-ja do t'a vlerësonte së tepërmi paraqitjen e argumenteve dhe arsyeve, më në hollësi, të të dhënave dhe kriterëve që KLSH-ja ka pasur ndaj QKK-së, qysh kur e ka vendosur atë në planin e saj vjetor të auditimit. Pra, përpara se të realizonte intervistën/pyetësorin. Diçka

e tillë kërkohet në kuadër të përmirësimit të veprimtarisë institucionale të QKK-së, në mënyrë të tillë që, kjo e fundit të jetë e vetëdijshme se çka përbën risk, të çfarëdo shkalle, për të...

\*\*\*

... në lidhje me sistemin e aplikimeve online, të njohur prej domain-it të tij, filmcoproduction.com, ndër problematikat e tjera, shënojmë se pranë zyrës së arkivës dhe protokollit të QKK-së nuk disponohen termat e referencës, si dhe specifikimet teknike për këtë shërbim, as në zanafillën e këtij procesi, e as në fazat e mirëmbajtjes së tij. Mendojmë që, diçka e tillë, do të duhej të ishte pasqyruar në projekt-raport. Njëkohësisht, edhe të dhënat e prodhuara ndër vite në këtë sistem, në qoftë se vijojnë që të jenë ruajtur pranë kompanisë, nuk mund të merren me garancinë e duhur, duke qenë se dosjet përkatëse, të cilat, kanë rezultuar nga aplikimet online, nëpërmjet këtij sistemi, nuk janë protokolluar. ...

\*\*\*

Në lidhje me bazën e të dhënave, shënojmë se, me dokumentet, të cilat, janë ngarkuar në sistemin e aplikimeve online, janë realizuar aplikimet nga viti 2017 gjer më 2023. Këto dokumente janë shqyrtuar nga (a) Komisioni Financiar, ku bën pjesë drejtori i financës pranë Ministrisë së Kulturës, sipas statutit të QKK-së të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, (b) Këshillat Miratues të Projekteve, (c) Komisioni i Shqyrtimit Paraprak, ku kanë marrë pjesë edhe ish-kryetarët e QKK-së. Nga këto janë krijuar dosje, të cilat, janë depozituar në arkivin e QKK-së. Njëkohësisht, nëpërmjet tyre janë dhënë edhe financime. Thënë me fjalë të tjera, sistemi i aplikimeve online ka shërbyer vetëm për transmetimin, në rrugë elektronike, të skedarëve. Pra, ky sistem, praktikisht, thjesht e vetëm ka zëvendësuar postën elektronike, e-mail.

\*\*\*

Sikurse i është bërë me dije KLSH-së, nga intervista, nga komunikimet e drejtpërdrejta, nga përgjigja ndaj akt-konstatimeve, të vetmet sisteme të teknologjisë së informacionit që QKK-ja disponon aktualisht, dhe përdor, janë sistemet e shfrytëzimit (operating systems), Microsoft Windows, të instaluar në ordinatoret e secilit nëpunës...

Për kushtet e gjertanishme të QKK-së, (a) pasja e rregulloreve dhe procedurave për TIK-un, (b) identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK, (c) procedurat e back-up, (d) menaxhimi i incidenteve dhe problemeve, (e) administrimi i log-eve, (f) vazhdimësia e ofrimit të shërbimeve dhe rimëkëmbjes nga katastrofat, nuk mund të mund të gjejnë zbatim në mungesë të sistemeve të teknologjisë së informacionit...

\*\*\*

... sistemi i aplikimeve online për projekte filmcoproduction.com, i zhvilluar rreth vitit 2016, për standardet e vitit 2025, mund të konsiderohet pa asnjë mëdyshje si «jashtë standardi». Për më tepër, duhet të kishte dalë edhe jashtë përdorimi, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave me №30, të ndryshuar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sjellim në vëmendjen tuaj se në bazë të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH është institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, i pavarur, i cili i ushtron kompetencat e tij duke iu nënshtuar Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. KLSH auditon në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualët në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 9, pika 1, Kreu I, Plani i auditimeve, citohet se:

Kontrolli i Lartë i Shtetit vendos në mënyrë të pavarur dhe në çdo kohë për planin e veprimtarisë së tij;

po ashtu në nenin 15, shkronja dh, e, Kreu II, Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së citohet se: dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake;

e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij.

\*\*\*

Përsa i përket sistemit të aplikimeve online argumentet e parashtruara nga ju janë përsëritje të konstatimeve të grupit të auditimit, të cilat janë diskutuar dhe pranuar nga ana juaj edhe përgjatë fazës së terrenit, si dhe observacioneve të paraqitura mbi akt konstatimet e lëna nga grupi i auditimit.

\*\*\*

Ashtu sikur është diskutuar gjatë fazës së terrenit me titullarin e QKK të dhënat e ruajtura në sistemin e aplikimeve online janë të rëndësishme, pasi në këto të dhëna përfshihen: të dhënat e aplikantëve, kontratat e financimit me QKK, skenari i filmit, marrëveshje me bashkë producent vendas dhe të huaj, lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre etj. Gjithashtu nga dokumentacioni i shqyrtuar nga grupi i auditimit në lidhje me procedurat e prokuruarat për këtë sistem rezultoi se ka pasur përditësime të vazhdueshme, për të cilat nuk disponon asnjë dokumentacion në lidhje me realizimin apo jo të shërbimeve të prokuruarat nga vetë QKK. Si dhe nuk mund të shpreheni se ky sistem ka zëvendësuar postën elektronike, e-mail, pasi është inekzistent për QKK për aq kohë sa i gjithë administrimi i tij qoftë software dhe hardware i është lënë kompanisë që e ka zhvilluar këtë sistem. Përsa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

\*\*\*

Në lidhje me observimin mbi pasjen e rregulloreve dhe procedurave për TIK, sikurse është observuar dhe nga vetë ju me observacionet e paraqitura mbi akt konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, shpreheni se: *“Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2025 janë parashikuar zë i veçantë për trajnimet TIK në vlerën 450 mijë lekë pa TVSH si dhe 1 milion lekë pa TVSH për pajisje TIK si servera, firewall fizik etj” si dhe “Në regjistrin e parashikimeve për prokurimin, për vitin 2025, është caktuar një shumë prej 1.000.000 lekë për pajisjen e QKK-së me serverët dhe firewall fizikë”,* gjë që bie në kundërshtim me observimin tuaj të fundit. Përsa i përket administrimi të log-eve si dhe kushteve akutale që institucioni juaj është observacioni juaj merret në konsideratë, si dhe është trajtuar duke reflektuar ndryshimet në këtë Raport Auditimi, pjesa tjetër e konstatimeve lidhet me nevojën për përmirësim të situatës së konstatuar, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

\*\*\*

Sjellim në vëmendjen tuaj se nga viti 2016 kur është zhvilluar sistemi deri në vitin 2023 nga QKK janë bërë investime si në shërbim mirëmbajtje, up-date të sistemit, Up-date i dokumentave të të gjitha projekteve, Up-date i kërkesave të detyrueshme të të gjitha projekteve etj, ku investimi i bërë kap vlerën 1,407,200 lekë me TVSH. Gjithashtu, ju rikujtojmë se grupi i auditimit për çdo procedurë për këtë sistem që nga implementimi deri në mirëmbajtje / zhvillime të mëtejshme nuk rezultoi të jenë marrë në dorëzim nga komisionet e blerjeve me vlerë të vogël shërbimet përkatëse në lidhje me sistemin e aplikimit on line të QKK në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Përsa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

#### IV. REKOMANDIME

##### B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve, që mund të ndodhin në infrastrukturën TI, në përputhje me praktikat më të

mira. Mungesa e masave dhe e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që QKK të mos identifikojë dhe mos dokumentojë trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e TI në QKK, si dhe mos menaxhim të risqeve me efekt negativ në TI dhe në proceset e punës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa në vijimësi për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve, menaxhimin e ndryshimeve, si dhe vlerësimin e nevojave për burime të dedikuara apo trajnime në varësi të llojit të problematikave.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Teknologjia e Informacionit në QKK zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. QKK nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave, ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

Gjithashtu, në rregulloren e përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve, miratuar me nr. 168 prot., datë 27.05.2024 nga Kryetari i QKK-së, si dhe me përditësimin e kësaj rregullore me nr. 60 prot., datë 27.01.2025 “Rregullore e përgjithshme e Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, janë lënë terma të cilat mund të sjellin konfuzion për aplikantët, ku jepet mundësia për ngarkimin dhe shqyrtimin e projekteve në një sistem për paraqitjen e projekteve për konkurim të cilin aktualisht QKK e ka hequr nga përdorimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit, duke marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të funksionimit të saj.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.2 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për përditësimin e rregullores së përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe të Lejeve, si një dokument mbi të cilin ky institucion bazohet për të kryer funksionet e tij, duke bërë një përshkrim më të detajuar për aplikantët në përputhje me kushtet aktuale dhe përputhshmërinë me ndryshimet që do të kryej në vazhdimësi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë fusha e teknologjisë së informacionit mbulohet nga një punonjësi, i cili bënë detyra shtesë të cilat nuk i ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të QKK. Ky punonjës aktualisht është specialist IT në QKK, i cili nuk ka kaluar si pjesë e strukturës së AKSHI-t, në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, ku strukturat përgjegjëse TIK të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për kalimin e strukturës përgjegjëse TIK tek AKSHI në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk ka miratuar një strategji institucionale zhvillimi, e cila do të duhej të përfshinte edhe komponentët e teknologjisë së informacionit që mbështesin realizimin e objektivave institucionale, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikatat më të mira të fushës. Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk disponon regjistër risku, ku të përfshihen dhe risqet e teknologjisë së informacionit, për periudhën objekt auditimi nuk u konstatua asnjë gjurmë e dokumentuar për risqet e identifikuar. Veprime në kundërshtim me nenin 11, pika 2, nenin 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”. Kjo sjell mungesë të identifikimit dhe adresimit të problematikave potenciale, si dhe rrit riskun për shkelje në fushën e sigurisë së informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie institucionale gjithëpërfshirëse, në të cilën të integrojë edhe komponentët e teknologjisë së informacionit, si një faktor mbështetës për përmbushjen e objektivave të saj.

*Në vijimësi*

**4.2 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës për risqet, ku të përfshijë edhe elemente të Teknologjisë së Informacionit, me qëllim analizimin, vlerësimin e tyre dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë për periudhën objekt auditimi për vitet 2023-2024 nuk ka pasur plan trajnimi vjetor, si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për burimet njerëzore, të cilët mbulojnë fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe punonjës të cilët janë përdorues të pajisjeve dhe sistemeve teknologjike, në kundërshtim me Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, si dhe standardet ndërkombëtare të TI për rritjen e kapaciteteve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime për burimet njerëzore që mbulojnë fushën e Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që nxit dhe përmirëson kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional. Trajnimet mbi teknologjinë e informacionit nevojitet të kryhen dhe tek punonjësit e tjerë, duke pasur parasysh elementët më të rëndësishëm si ruajtja e të dhënave, të drejtat dhe detyrimet mbi mjetet teknologjike që disponon institucioni dhe ka vënë në përdorim të punonjësve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë përdor sistemet AMS (Sistemi i Menaxhimit të Aplikimeve) dhe SQDNE (Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik) të cilat janë zhvilluar nga AKSHI, për ofrimin e katër shërbimeve online (1. Aplikim për regjistrimin vjetor të Producentëve, 2. Aplikim për regjistrimin vjetor të Distributorëve/Difuzorëve, 3. Aplikim për konfirmim financimesh për projektet e miratuara dhe 4. Aplikim për pajisje me leje qarkullimi filmat që shfaqen në territorin e Republikës së Shqipërisë), nga ku u konstatua se:

- Për sistemet AMS dhe SQDNE përdor vetëm rolin specialist për të gjitha hapat e procesit në sistem. Rolet Përgjegjës, Drejtor, Titullar, Pritës dhe Monitorues, të cilat janë në sistem nuk përdoren nga punonjësit përkatës sipas funksionit që secili prej tyre ka. Kjo praktikë bën që i gjithë procesi të realizohet nga roli specialist, duke rritur ndjeshëm riskun e mbivendosjes së attributeve dhe të drejtave të aksesit në sistem, si dhe duke cenuar ndarjen e nevojshme të përgjegjësi.

- Komisionet përgjegjëse për kryerjen e vlerësimeve, sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të QKK-së, nuk aksesojnë drejtpërdrejt sistemet për të marrë dhe vlerësuar dokumentacionin e gjeneruar nëpërmjet tyre. Dokumentacioni u vihet në dispozicion nga specialisti i IT-së, i cili është i vetmi person i autorizuar nga titullari për të pasur akses në sistem, pavarësisht se nuk është pjesë e këtyre komisioneve, duke cenuar parimin e pavarësisë dhe transparencës së procesit të vlerësimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për përcaktimin dhe delegimin e qartë të lidhjes ndërmjet pozicionit të punës dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë si përdorues i sistemeve AMS dhe SQDNE, ku secili përdorues të ketë akses për kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas funksionit të tyre.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit AMS u konstatua se:

- QKK nuk disponon një rregullore të miratuar për përdorimin e modulit të AMS. Punonjësit të cilët merren me përdorimin e tij i referohen disa tutorialeve që i janë vendosur në dispozicion nga AKSHI, ku nga verifikimi i tyre rezultoi se i përkasin modulit AMS për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH);

- Gjatë përdorimit të këtij sistemi ka vonesa të vazhdueshme në procesin e shqyrtimit të aplikimeve nga specialisti përgjegjës për QKK, duke ndikuar negativisht në efektivitetin e procesit;

- Ekzistojnë rekorde testimi nga operatori të cilat shfaqen në sistemin live, duke rritur riskun e të dhënave të pasakta;

- Ekzistojnë rekorde të cilat i përkasin të njëjtit aplikues dhe nuk shfaqen tek Aplikimet e dubluara, duke sjellë dublime të aplikimeve dhe mos identifikim të aplikimit të duhur;

- Tek aplikimet e përfunduara dalin të gjitha aplikimet e bëra edhe nëse aplikimi është refuzuar ose është i dubluar, duke mos bërë të mundur identifikimin e aplikimeve të trajtuara;

- Aplikanti mund të bëjë disa aplikime për një shërbim të caktuar, duke upload-uar dokumentat e njëjta. Këto raste dalin të gjitha në sistem dhe pse janë të dublikuara për të njëjtin aplikant. Nuk është e mundur që nëse aplikimi i parë është bërë gabim të vazhdojë procedura sërish tek i njëjti rekord duke shmanget dublikimet;

- Për shërbimet e ofruara nuk është i mundur gjenerimi i statistikave, pasi aplikimet të cilat janë trajtuar brenda afatit dalin tek sesioni jashtë afatit, duke mos bërë një raportim të saktë në lidhje me trajtimin e aplikimeve përkatëse.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë, si përgjegjëse për të dhënat e katër aplikimeve që ofrohen online dhe administrohen nëpërmjet sistemit AMS, të marrë masa për adresimin e parregullsive tek AKSHI në lidhje me përmirësimin, rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi, me qëllim saktësimin, plotësimin dhe sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit nëpërmjet sistemit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023 ka përdorur sistemin e aplikimit online të projekteve të QKK [filmcoproduction.com](http://filmcoproduction.com), të cilin nuk e ka më në përdorim dhe nuk disponon kodin burim të tij. Kodi burim dhe i gjithë informacioni i ruajtur në të administrohet nga operatori, i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tij, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK

në *Administratën Publike*”, të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI.

Gjithashtu, konstatohet se QKK nuk ka marrë masa në lidhje me marrjen e bazës së të dhënave që ky sistem përmban dhe që ka gjeneruar ndër vite që nga implementimi i këtij sistemi që prej vitit 2016 deri në vitin 2023, si dhe nuk ka dijeni të të dhënave që ky sistem ka disponuar për këtë periudhë kohore ku përfshihen të dhënat e aplikantëve që ky sistem kishte si psh., kontratat e financimit me QKK, skenari i filmit, marrëveshje me bashkë producent vendas dhe të huaj, lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre etj, të përcaktuara në rregulloret e QKK ndër vite.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim marrjen e bazës së të dhënave për sistemin e aplikimit online të projekteve të QKK, si dhe kodit burim për këtë sistem, duke mundësuar arkivimin e dokumentacionit të ruajtur në të, importimin e të dhënave të ruajtura në sistem për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshmërisë së të dhënave të aplikimeve që janë kryer ndër vite në QKK. Gjithashtu të sigurohet që pas transferimit, këto të dhëna nuk ruhen tek Operatori Ekonomik në kushtet kur pjesë e tyre janë dhe të dhëna personale të cilat mbrohen me ligj.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për ndjekjen e kërkesës së saj në lidhje me zhvillimin e një shërbimi në platformën e-Albania dhe nuk ka saktësuar informacionin e kërkuar nga AKSHI për implementimin e sistemit të aplikimeve online. Megjithëse AKSHI i ka vënë në dispozicion një server virtual, QKK nuk ka ndërmarrë masa për hostimin e aplikacionit web për sistemin e aplikimeve online të projekteve sipas kërkesave të vetë institucionit, duke vijuar kontratat me operatorin ekonomik pa përcaktuar vendndodhjen e hosting-ut dhe pa siguruar kontrollin administrativ mbi sistemin dhe të dhënat që ai përmban.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për vazhdimin dhe finalizimin e zhvillimit të shërbimit online për aplikimet për mbështetje financiare të projekteve në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit, me qëllim përmbushjen e objektivave institucionale dhe zbatimin e kërkesave ligjore për ofrimin e shërbimeve vetëm në mënyrë elektronike.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023, Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk ka kryer një analizë të plotë për identifikimin dhe klasifikimin e sistemeve dhe të dhënave konfidenciale që përdoren në mënyrë të vazhdueshme ose të përkohshme, në përputhje me veprimtarinë e saj. Gjithashtu, nuk janë hartuar plane për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit si dhe plan të rimëkëmbjes në rast të një ndërprerje nga arsye të ndryshme që mund të jenë natyrore, njerëzore apo fizike, në kundërshtim me pikën 1, shkronjat c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar. Këto mangësi sjellin humbje të të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa për përcaktimin e sistemeve dhe të dhënave konfidenciale, të cilat aksesohen nga institucioni përkohësisht apo në vazhdimësi. Gjithashtu, të hartohen planet e vazhdimësisë së institucionit dhe planet për backup në çdo drejtim të nevojshëm të teknologjisë dhe sistemeve informatike, për të minimizuar riskun e humbjes së të dhënave që ndikojnë në ecurinë dhe aktivitetin e institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë ndodhen disa kopje të filmave të projekteve filmike të financuara nga QKK ndër vite, por jo të gjitha janë të aksesueshme, pasi lexueshmëria e tyre varet nga pajisjet me të cilat janë dorëzuar, duke vështirësuar procesin e dixhitalizimit dhe arkivimit. Gjithashtu, këto materiale nuk janë lënë në ngarkim të punonjësve specifikë për ruajtjen, menaxhimin si dhe pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Gjithashtu, konstatohet se vetëm një kopje e filmave të projekteve ruhet në NAS-in e QKK-së, në kuadër të backup-it, procedurë kjo e cila nuk është e dokumentuar apo pasqyruar në një akt administrativ.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë të marrë masa të menjëhershme për caktimin e personave përgjegjës për menaxhimin e filmave të dorëzuar në QKK, për çdo projekt filmik të financuar ndër vite.

Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave specifike dhe procedurave të standardizuara që garantojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe vazhdimësinë e përdorimit të këtyre materialeve.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023 QKK ka investuar për sistemin e aplikimit online të projekteve, ku vlera e investimit për implementimin dhe mirëmbajtjen e tij ka shkuar 1,407,200 lekë me TVSH. Kjo shumë është llogaritur nga grupi i auditimit bazuar në faturat tatimore të paguara nga QKK, pasi në kontabilitetin e QKK nuk ka një vlerë kontabël të regjistruar për këtë sistem. Nga auditimi u konstatua se, sistemi i aplikimit online të projekteve të QKK [filmcoproduction.com](http://filmcoproduction.com) është përdorur deri në vitin 2023 dhe nuk përdoret më. Gjithashtu ky sistem është inekzistent për QKK pasi i gjithë administrimi si software ashtu edhe hardware i është lënë operatorit ekonomik që e ka zhvilluar këtë sistem, si dhe QKK nuk ka asnjë mundësi për aksesimin e dokumentacionit ndër vite të gjeneruar nëpërmjet këtij sistemi. Për çdo procedurë për këtë sistem që nga implementimi deri në mirëmbajtje / zhvillime të mëtejshme nuk rezulton të jenë marrë në dorëzim nga komisionet e blerjeve me vlerë të vogël shërbimet përkatëse, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në rregulloren e re që QKK ka miratuar me nr. 60 prot., datë 27.01.2025 të QKK nuk është përcaktuar më aplikimi nëpërmjet sistemit por është përcaktuar që aplikimi do të realizohet nëpërmjet email-it. Nga komunikimi me subjektin gjatë fazës së auditimit në terren, si dhe nga informacioni i përcjell me e-mail konstatohet se, për këtë ndryshim mungon relacioni në të cilin të sqarohet përse aplikimi online nëpërmjet sistemit të aplikimit online të projekteve të QKK [filmcoproduction.com](http://filmcoproduction.com) është zëvendësuar me praktikën e aplikimit nëpërmjet email-it. Gjithashtu, mungon informacioni në lidhje me vazhdimësinë e tij pavarësisht se ky sistem ka qenë funksional.

Përsa më sipër vlera e investimit në shumën 1,407,200 lekë me TVSH përbën investim pa efikasitet dhe efektivitet për institucionin.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Qendra Kombëtare e Kinematografisë në të ardhmen të marrë masa për një vlerësim të plotë dhe të argumentuar të investimeve lidhur me metodologjitë apo praktikat që vendos të zbatohet në procesin e aplikimit për projektet që konkurrojnë, shqyrtohen,

miratohen dhe financohen nga institucioni, me qëllim eliminimin e efektit negativ të konstatuar dhe të sigurohet menaxhimi me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37, nenin 203 pika 1 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i kërkojmë titullarit që në varësi të kompetencave të tij ligjore, duke vlerësuar mangësitë e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

### **D.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish-punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**